



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
DREJTORIA JURIDIKE DHE MENAXHIMIT TË ASETEVE
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1503 / prot

Koplik më: 05 / 06 / 2026

PROJEKT -VENDIM
Nr _____, Datë 05 / 06 / 2026

PËR
MIRATIMIN E PËRDORUESIT FAKTIKE TË TOKËS BUJQËSORE PER FSHATIN KTOSH
NJESIA ADMINISTRATIVE GRUEMIRE

Bazuar ne shkresën nr.4726 datë 22.05.2026 të Drejtorisë Vendore ASHK Shkodër si dhe në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” pika 3 neni 14 dhe të VKM –së 1182 /2020 “Për miratimin e rregullave të lëshimit të akteve të kalimit në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore dhe të modelit të aktit individual të kalimit në pronësi të tokës bujqësore” pika 10.

VENDOSI:

Që ti propozojë Këshillit të Bashkisë Malësi Madhe :

- I-** Të miratojë përdoruesin faktik të tokës bujqësore, z.Rexhë Islam Smakaj për fshatin Ktosh Njësia Administrative Gruemire, Bashkia Malësi e Madhe, Zona Kadastrale 2299 sipas dokumentacionin përkatës të sjellë nga Drejtoria Vendore Ashk Shkodër.
- II-** Për zbatim të këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Vendore Ashk Shkodër.

Bashkangjitur gjeni dokumentacionin e paraqitur nga ASHK Drejtoria Vendore Shkoder.

Faleminderit për mirëkuptimin!

KRYETAR
TONIN MARINAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
DREJTORIA VENDORE SHKODER

4720
Nr. Prot

22.05.2026
Shkodër, më 20.05.2026

Lenda: Ridërgim i dokumentacionit "Për miratimin e përdoruesve faktikë të tokës bujqësore", në zbatim të pikës 3 të Nenit 14 të Ligjit 20/2020 dhe pikës 9 të VKM 1182/2020.

Drejtuar:

Këshillit Bashkiak Malësi e Madhe

Adresa : KOPLIK

Nga ana e Taks-Forces të ngritur me VKM-ne nr.320/2023 në bashkëpunim me përfaqësuesit e Drejtorisë Vendore ASHK Shkodër, po kryhet procesi i kalimit të tokës bujqësore nga përdorimi në pronësi në zbatim të Kreut 2, Seksionit 3, të Ligjit 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH", si dhe VKM-së nr.1182/2020 "Për miratimin e rregullave të lëshimit të akteve të kalimit në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore dhe të modelit të aktit individual të kalimit në pronësi të tokës bujqësore", konkretisht për fshatin Ktosh, zk.2299, Njësia Administrative Gruemirë, Bashkia Malësi e Madhe.

Me shkresë nr.4945 prot dt.15.10.2024, DVASHK Shkodër, ka dërguar për afishim pranë Bashkisë Malësi e Madhe planvendosjet e subjektit Rexhë Islam Smakaj.

Me shkresë nr.567/1 dt.21.02.2025, (administruar pranë DV ASHK Shkodër me nr.4945/1 prot.hyrës, datë 24.02.2025), Bashkia Malësi e Madhe ka konfirmuar afishimin fizik në Njësia Administrative Gruemirë **dhe konfirmon se nuk ka pasur asnjë ankimim.**

Në vijimësi të procedurës "Për miratimin e përdoruesve faktikë të tokës bujqësore" sipas pikës 3 të Nenit 14 të Ligjit 20/2020 dhe pikës 9 të VKM 1182/2020, po ju përcjellim për miratim relacionet së bashku me dokumentacionin përkatës (planvendosje të pasurisë), për subjektin e mësipërm.

Bashkëlidhur: shkresa nr.2006 prot, datë 20.03.2025 së bashku me relacionin dhe planvendosjen

Faleminderit !

DREJTORI
EGLANTINA FRROKU



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Shkodër
Date 2026/05/22 13:30:03 +02'00'
32waSHKODER2026052213295675014

Eglantin
a

Digitally signed by
Eglantina Frroku
Date: 2026.05.22
12:43:55 +02'00'

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria Vendore Shkodër)

Amëla

PLANVENDOSJE E NGASTRËS PËR KALIMIN NË PRONËSI
PA SHPËRBLIM TË TOKËS BUJQËSORE PËR PËRDORUESIT

DVASHK SHKODER BASHKIA MALESI E MADHE

NR.KËRKESËS: 29 DATË: 06/10/2020

SEKTORI:

SEKTORI:

SPECIALIST:Ing.Erjeta RAMAJ SPECIALIST:

PERGJEGJES:Suad Smakaj PERGJEGJES:

ZONA KADASTRALE: 2299

NUMRI PASURISE: 439/1

INDEKSI I HARTES: K-34-64-(143-A)

SHKALLA: 1 : 2500

SIPËRFAQJA E NGASTRËS BUJQËSORE - 2250m2

ZËRI KADASTRAL ARE

SUBJEKTI: REXHE ISLAM SMAKAJ


emër atësi mbiamër

DATA: 23/08/2024

DATA: / /

X:454253.354
Y:4694276.441

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



KUFITARËT:

VERI: PASURIA 439/2 Rruge Kalimi
JUG: PASURIA 439/2 Manaj
LINDJE: PASURIA 439/2 Fatmir Salihaj
PERËNDIM: PASURIA 439/2 Fatmir Salihaj

LEGJENDA: // SIPËRFAQJA E NGASTRËS PËR KALIM PRONËSIE




Valosur elektronikisht nga Drejtoria
Veriore Shkoder
Date: 2024/08/30 13:57:15 +0200
226 SH-400E/2024/08/30/13:57:15

MIRATOI

PËRFAQËSUESI AUTORIZUAR I NJVJ

Shënim: Ky dokument është gjerësisht i vullnetshëm dhe nëse
të një procedurë automatike nga një sistem elektronik (Procedura e Vendi)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
DREJTORIA VENDORE SHKODER

Nr. 4900E
Prot

Shkodër, më 20.03.2025

Lenda: Përcjellje e dokumentacionit "Për miratimin e përdoruesve faktikë të tokës bujqësore", në zbatim të pikës 3 të Nenit 14 të Ligjit 20/2020 dhe pikës 9 të VKM 1182/2020.

Drejtuar:

Këshillit Bashkiak Malësi e Madhe

Adresa : KOPLIK

Nga ana e Taks-Forces të ngritur me VKM-ne nr.320/2023 në bashkëpunim me përfaqësuesit e Drejtorisë Vendore ASHK Shkodër, po kryhet procesi i kalimit të tokës bujqësore nga përdorimi në pronësi në zbatim të Kreut 2, Seksionit 3 të Ligjit 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH", si dhe VKM-së nr.1182/2020 "Për miratimin e rregullave të lëshimit të akteve të kalimit në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore dhe të modelit të aktit individual të kalimit në pronësi të tokës bujqësore", konkretisht për fshatin Ktosh, zk.2299, Njësia Administrative Gruemirë, Bashkia Malësi e Madhe.

Me shkresë nr.4945 prot dt.15.10.2024, DVASHK Shkodër, ka dërguar për afishim pranë Bashkisë Malësi e Madhe planvendosjet e subjektit Rexhë Islam Smakaj.


Me shkresë nr.567/1 dt.21.02.2025, (administruar pranë DV ASHK Shkodër me nr.4945/1 prot.hyrës.datë 24.02.2025), Bashkia Malësi e Madhe ka konfirmuar afishimin fizik në Njësia Administrative Gruemirë **dhe konfirmon se nuk ka pasur asnjë ankimim.**

Në vijimësi të procedurës "Për miratimin e përdoruesve faktikë të tokës bujqësore" sipas pikës 3 të Nenit 14 të Ligjit 20/2020 dhe pikës 9 të VKM 1182/2020, po ju përcjellim për miratim relacionet së bashku me dokumentacionin përkatës (planvendosje të pasurisë), për subjektin e mësipërm.

Faleminderit !

DREJTORI
EGLANTINA FRROKU

Eglantin
a



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
DREJTORIA SHKODER

RELACION

MBI TRAJTIMIN E KËRKESËS NR. 29 PROT. DT. 06.10.2020 PËR KALIMIN PA SHPËRBLIM TË TOKËS BUJQËSORE NGA PËRDORIMI NË PRONËSI PËR SUBJEKTIN REXHË ISLAM SMAKAJ.

Subjekti REXHË ISLAM SMAKAJ, me kërkesën nr. 26 datë. 06.10.2020, ka paraqitur pranë Bashkisë Malësi e Madhe, kërkesën për kalimin në pronësi të tokës bujqësore që ai posedon në fshatin Ktosh, Njësia Administrative Gruemirë, me sipërfaqe 2250 m², nga përdorimi në pronësi dhe konkretisht parcela: 1-Ngastra 439/1 me sipërfaqe 2250 m².

Parashtrimi i fakteve:

Situata ligjore

-Kërkesa e subjektit nr.29 prot. dt. 06.10.2020 është paraqitur pranë Njësive të Vetëqeverisjes Vendore Shkrel, brenda afatit ligjor 6 (gjashtë) mujor nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 20/2020 "Për Përfundimin e Proceseve Kalimtare të Pronësisë në Republikën e Shqipërisë".

Referuar korrespondencës së mbajtur me DAMT, konkretisht me shkresën nr. 315/2 prot dt. 14.08.2023 (administruar pranë ZV ASHK Malësi e Madhe me nr.2645/1 prot.hyrës,datë 17.08.2023) konfirmohet se Ktoshi është pjesë e ish-kooperativës bujqësore Grizhë.

-VKM nr. 1182/2020 pika 4.1, subjekti kerkues rezulton me gjendje familjare dt. 01.08.1991 ne fshatin Gjormë,pjesë e ish-kooperativës bujqësore Grizhë, dhe me certifikatën familjare te familjes bujqesore dt. 25.02.2025 në fshatin Ktosh. Nga ana e subjektit është përcjellë dokumentacion në cilësinë e trashëgimitarit ligjor toka e të cilit është marrë nga ana gjatë reformës agrare dhe vërtetim që ka qenë anëtarë i ish-kooperativës bujqësore Grizhë(administruar pranë ZV ASHK Malësi e Madhe me nr.75/144 prot,datë 14.05.2024)

-Pika 4/1/b e vkm 1182/2020 ka përcaktuar se subjekti, që ka paraqitur kërkesë për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore,nuk duhet të ketë përfshuar tokë bujqësore në territorin e ndonjë ish-kooperative apo ish-ndërmarrjeje bujqësore tjetër. Për vlerësimin e këtij kushti, ASHK-ja shqyrton dokumentacionin e administruar nga struktura e kadastrës së rrethit, referuar vendbanimit në datën 1.8.1991 dhe vendbanimit aktual, në raport me vendndodhjen e pronave për të cilat subjekti kërkon të pajiset me aktin e marrjes së tokës në pronësi.

Subjekti që kërkon të trajtohet me AMTP në zbatim të ligjit 20/2020 dhe vkm 1182/2020 nuk është trajtuar me AMTP në territorin e ndonjë kooperative apo ish-ndërmarrje bujqësore.

Në lidhje me kriteret që duhet të plotësojë ngastra:

-Pika 4/2/a percakton se "T"i përkasë një prej llojeve të tokës bujqësore (arë, pemëtoje, vresht dhe ullishte), në momentin e miratimit të vendimit të kalimit në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore. Për verifikimin e llojit të pasurisë, ASHK-ja i referohet dokumentacionit të administruar nga Drejtoria e Administrimit të Tokës, si: librat e tokës, librat e ngastrave të fshatit, regjistrat apo dokumentacioni ku janë pasqyruar të dhëna dhe

tregues për tokën bujqësore apo për kategorinë e resursit të tokës, gjatë periudhës 29 gusht 1945 deri në 19 shtator 1991, hartat kadastrale të afërta me momentin e miratimit të vendimit të kalimit në pronësi, si edhe aktet e organeve publike, nëpërmjet të cilave janë realizuar ndryshime apo kalime të tokës bujqësore në resurse të tjera dhe anasjelltas.

Nga verifikimi i parcelës të sipër cituar për kalim pronësie rezulton brenda konfiguracionit të hartës së DAMT me zërin kadastral arë, kusht për llojin e tokës sipas VKM 1182 /2020 pika 4.2.

- Toka bujqësore për të cilën kërkohet kalimi i pronësisë nuk rezulton të jetë në pronësi të të tretëve. Për këtë qëllim janë verifikuar regjistrimet. Nga baza e të dhënave rezulton se pasuria është shtet në volum 4, faqe 45; të ZK.2299. Gjithashtu janë verifikuar AMTP-të e parregjistruara që na janë vënë në dispozicion nga arkiva e Zyrës Vendore Malësi e Madhe dhe dokumentacioni i përcjellë nga DAMT.

-Toka bujqësore për të cilën kërkohet kalimi i pronësisë nuk është objekt i formave të kompensimit fizik sipas ligjit nr. 133/2015” Për Trajtimin e Pronës dhe Përfundimin e Procesit të Kompensimit të Pronave”. Referuar korrespondencës së mbajtur me ATP-në shkresa nr.prot. 723/1 dt. 23.02.2024 administruar pranë ASHK Shkodër me prot. 690/1 dt. 26.02.2024 konfirmohet që toka nuk është objekt i formave të kompensimit fizik sipas ligjit nr. 133/2015.

-Toka bujqësore për të cilën kërkohet kalimi i pronësisë nuk është objekt i investimeve strategjike, sipas legjislacionit në fuqi për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë. AIDA me shkresën nr.315/1 prot. dt. 20.02.2024 administruar pranë zyrës me nr. 689/1 prot. Dt. 22.02.2024 ka konfirmuar toka bujqësore për të cilën kërkohet kalimi i pronësisë nuk është objekt i investimeve strategjike.


Dokumentacioni i administruar:

- Nga ana e subjektit Rexhë Islam Smakaj janë depozituar: kërkesa nr.29 dt. 06.10.2020, certifikatë familjare 01.10.2020 ku pasqyrohet përbërja familjare dt.01.08.1991.
- Kthim përgjigje në përgjigje të shkresës së ZV ASHK Malësi e Madhe 75/64, datë 19.03.2024 (administruar pranë ZV Malësi e Madhe me nr.75/144 prot.hyrës, datë 14.05.2024).
- Nga DAMT-ja është përcjellur dokumentacioni me shkresën nr. 108/1 prot dt. 04.03.2024 (administruar pranë ZV ASHK Malësi e Madhe me nr.75/35 prot.hyrës, datë 06.03.2024).

Nga Bashkia Malësi e Madhe janë administruar shkresat:

- Shkresa nr.667/55, datë 17.09.2024 (administruar pranë DV ASHK Shkodër me nr.3882/1 prot.hyrës, datë 19.09.2024) ku është konfirmuar dhe përcjellë e nënshkruar planvendosja nga ana e Bashkisë.
- Shkresa 567/1, datë 21.02.2025 administruar pranë DV ASHK Shkodër me nr.4945/1 prot hyrës, datë 24.02.2025 ku konfirmohet afishimi publik 30-ditor dhe që nuk ka pasur ankese gjatë kësaj periudhe.
- Shkresa ATP-së nr.prot. 723/1 dt. 23.02.2024 administruar pranë ASHK Shkodër me prot. 690/1 dt. 26.02.2024.
- Shkresa e AIDA nr.315/1 prot. dt. 20.02.2024 administruar pranë zyrës me nr. 689/1 prot. Dt. 22.02.2024

Situata faktike:



U krye verifikimi në terren në bashkëpunim me Bashkinë Malësi e Madhe. Gjatë këtij procesi mori pjesë përfaqësuesi i Njësise Vendore të Vetëqeverisjes i vënë në dispozicion nga Bashkia Malesi e Madhe z. Pal Marku.

Nga verifikimi në terren sipas akt konstatimit prot.58 dt. 04.03.2024 nga grupi i terrenit, u konstatua se subjekti posedon një parcelë me sipërfaqe **2250 m²** në fshatin Ktosh, pjesë e kooperativës bujqësore Grizhë, e konfirmuar nga Këshilli i Qarkut Shkodër, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës me shkresën nr.108/1 prot dt. 04.03.2024. Kjo sipërfaqe përfshihet në **Z.K. 2299**, të Njësise Administrative Gruemirë, Malësi e Madhe, konkretisht ngastra me numër pasurie **439/1**, me zërin kadastral arë sipas regjistrimit dhe DAMT, kusht për llojin e tokës sipas VKM 1182 /2020 pika 4.2 .

Gjatë verifikimit u konstatua se sipërfaqja totale e parcelave që kërkohet është **2250 m²**. Normativa e përlllogaritur nga diferenca e tokës së lirë bujqësore të përcaktuar sipas kriterëve të VKM 1182/2020 ku si procedurë është nxjerrë sipërfaqja e lirë e tokës shtet e llojit arë ,pemëtores,vreshtë,ullishte, janë zbrituar sipërfaqet e kanaleve vaditesë ,rugëve,si dhe llojet e pasurive troje,livadh, përrua(sipas hartës dhe dokumentacionit të DAMT, sipërfaqet e ndërtimeve dhe truallit funksional të tyre, si dhe trojet sipas ortofotos, po ashtu dhe sipërfaqes së tokës shtet të dhënë me AMTP nga njësia administrative Kastrat (bazuar në AMTP që janë të arkivuara në Zyrën Vendore ASHK Malësi e Madhe të pa regjistruara akoma) dhe numrit total të **banorëve aktual** të përcjellë nga zyra e gjendjes civile njësia administrative Shkrel me shkresën nr. 40/1 prot. me dt. 08.02.2024 kur numri i banorëve rezulton të jetë **1182** banorë. Sipërfaqja e lirë bujqësore shtet sipas regjistrimit fillestar është 2653787 m².

Sipërfaqet troje ,rugë,kanale , te regjistruara me AMTP , ndertesa etj, nga përputhja me hartën e DAMT 285893 m².

Referuar çertifikatës familjare të datës 25.02.2025 rezulton se familja bujqësore përbëhet nga 3 anëtarë në këto rrethana rezulton se sipërfaqja e kërkuar është brenda normativës **1900 m²/banorë**.

Me shkresën nr.4945 datë 15.10.2024 janë përcjellë pranë Bashkisë Malësi e Madhe për afishim lista e përdoruesve dhe paraqitja grafike e sipërfaqeve te kërkuar.

Me shkresën nr.567/1 date 21.02.2025 ka konfirmuar që ka përfunduar afishimi dhe nuk ka pasur ankesa (administruar pranë DV ASHK Shkodër me nr.4945/1 prot hyrës, datë 24.02.2025).

DREJTORI

EGLANTINA FRROKU



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Shkodër
Date: 2025/03/20 16:09:44 +02'00'
32JUSHKODER2025032016093721014

Eglantina

a
3

Digitally signed by
Eglantina Frroku
Date: 2025.03.20
16:37:58 +02'00'

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procesi automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria Vendore Shkodër)